

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Halil Zahiri, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, duke vendosur në procedure kontestimore të paditësit nga _____ të cilën me autorizim e përfaqëson _____, av. nga Gjilani, kundër të paditurit nga _____, II rr.7 nr.19, për pagesën e borxhit, në seancën gjyqësore dhe publike të datës 23.04.2018, mori dhe shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit nga _____, e ushtruar ndaj të paditurit nga _____ dhe **DETYROHET** i padituri, që në emër të përmbushjes së borxhit, sipas Marrëveshjes së dt. 21.03.2014, mbi shitblerjen e mallrave të ndryshme, t'i paguan paditësit shumën prej 3.250,00 €, me kamatë ligjore në shkallën prej 8 % dhe ate nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, me vërejtje të përmbartimit të detyruar.

II. DETYROHET i padituri nga _____, që paditësit nga _____, t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 534 €, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të vendimit, me vërejtje të përmbartimit të detyruar.

A r s y e t i m

Paditësi nga _____, përmes të autorizuarit të tij av. _____ në këtë Gjykatë më date 23.07.2018, ka ushtruar padi ndaj të paditurit nga _____ lidhur me përmbushjen e borxhit sipas marrëveshjes për shitblerjen e mallrave të ndryshme (të përdorura), në vlerë prej 3.250.00 €.

Pas pranimit të padisë kjo Gjykatë duke vepruar konform dispozitave të neni 394 dhe 395 të LPK-ës, palës së paditur ia ka dërguar një kopje të padisë dhe aktvendimit në mënyrë që i njëjti të përgjigjet lidhur me pretendimet e tij, ku i njëjti fare nuk është përgjigjur në padi.

Shqyrtimi përgaditor i dt.11.04.2018 dhe ai kryesor i dates 23.04.2018, me propozimin e përfaqësuesit të paditësit, av. _____ nga _____, është mbajtur në mungesë të të paditurit _____, pasi që i njëjti edhe pse ftesat i ka pranua në mënyrë të rregullt, më dt.31.01.2018 përkatësisht më dt.12.04.2018, të njëjtës nuk iu ka përgjigjur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesi me autorizim i paditësit av. _____ në seancën kryesor të mbajtur më dt.23.04.2018 ka deklaruar se mbetet në tërë pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i propozon gjykatës që të lexohen dhe administrohen të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike e sidomos pas marrëveshjes së palëve ndërgjyqëse mbi shitblerjen e mallrave ka kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta aprovojë në tërësi si të bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 8 të LPK-ës, Gjykata i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat nga lënda si vijon:

-Lexohet dhe administrohet marrëveshja e lidhur në mes palëve për shitblerjene mallrave nga veshmbathja më dt.21.03.2014 në Zyren e avokates në Prishtinë. Nga kjo prova gjykata konstaton se palate kontraktuese më dt.21.03.2014 me vullnetin e tyre kanë lidhur marrëveshjen për shitblerjene e mallërave, çmimi kontraktues është caktuar në lartësi prej 3.250,00 €, ndërsa afati i pagesës është caktuar nga palët kontraktuese deri më dt.21.03.2015, të njëjtën marrëveshje secila pale e ka nënshkruar personalisht pasi që në hyrje të kontratës secila pale i kishte dhënë të dhënat personale si pale në këtë marrëveshje.

Lexohet dhe administrohet fatura e pagesës së taksës gjyqësore. Nga kjo prove gjykata vërtetoi se paditësi e ka paguar taksën gjyqësore.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave materiale të deponuara në shkresat e lëndës dhe të lexuara në seancat gjyqësore, vlerësimin e rrethanave me rëndësi për vendosje meritore, gjykata aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar pasi që i padituri nuk i ka përmbushur detyrimet e marrura nga marrëveshja e lidhur në mes tyre lidhur me shtijën e mallrave të ndryshme (të përdorura), detyrime këto të parapara në nenin 438, 450 dhe 451 të LMD/Ligji nr.04-L/077 i dt.10 Maj 2012) mbi detyrimet e shitësit për dorëzimin e sendit dhe kohën dhe vendin e dorëzimit, kurse i padituri, përkundër pranimit të sendit nuk ka vepruar konform detyrimeve të marrura për pagesën e borxhit, në bazë të nenit 499 të LMD, për përmbushjen e detyrimeve sipas kohës dhe vendit të caktuar në marrëveshje.

Gjykata vendosi që në bazë të nenit 451.1 të LPK, shpenzimet e procedurës kontestimore t'i bartë i padituri dhe e detyroi atë që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 534 € edhe atë në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit nën kërcënimin ekzekutimit të dhunshëm, në emër të përfaqësimit të avokatit për tri (3) seancën gjyqësore në lartësi prej 405 €, për përpilimin e padisë 104 € dhe për dhe kompensimin e taksës gjyqësore shumën prej 25€.

Nga të cekurat më lartë, e në bazë të nenit 143 të LPK-ës dhe neneve, 438, 450, 451 dhe 499 të LMD-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate .

